

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR AMNISTINË FISKALE DHE PENALE PËR SUBJEKTET QË BËJNË DEKLARIM VULLNETAR TË PASURIVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji krijon premisat për një amnisti fiskale dhe penale me një afat 1-vjeçar, për subjektet, të cilat, në kushtet e procedurat e parashikuara në të dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, deklarojnë vullnetarisht pasuritë, me qëllim të ligjësimit të tyre dhe të formalizimit të aktiviteteve të krijuara gjatë 30 viteve të fundit.

Projektligji synon garantimin e procedurave transparente për të mundësuar ligjësimin e pasurive të padeklaruara dhe/ose të paregjistruara, tërësisht apo pjesërisht, si dhe për rivlerësimin e pasqyrave financiare të subjekteve. Ai parashikon, gjithashtu, procedurat e deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat dhe pasuritë që deklarohen, duke ofruar mekanizma nxitës, në kuptim të tarifave tatimore që do aplikohen dhe të afateve të deklarimit. Krahas aplikimit të një tatimi favorizues të posaçëm, me normë të veçantë, projektligji, gjithashtu, garanton ruajtjen e sekretit dhe të informacioneve që lidhen me këto pasuri, si dhe mosfillimin e procedurave administrative e të procedimeve penale ndaj këtyre subjekteve nga ana e institucioneve përkatëse, në lidhje me këto pasuri.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Në 30 vitet e fundit, pas ndryshimit të sistemit politik dhe kalimit në ekonominë e sipërmarrjes së lirë, krahas zhvillimeve pozitive dhe stabilitetit ekonomik të krijuar, në ekonominë shqiptare janë evidentuar edhe fenomene të informalitetit, të shmangies nga taksat dhe të punës së zezë.

Të gjitha këto elemente kanë dëmtuar zhvillimin e një ekonomie konkurruese dhe me rregulla të qarta loje. Ndër vite janë bërë përpjekje për reduktimin e informalitetit dhe formalizimin e ekonomisë. Tashmë vendi ynë ndodhet në kushtet kur tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia globale e shkaktuar nga COVID-19 kanë dëmtuar ekonominë, sipërmarrjet, biznesin në tërësi dhe financat publike të shtetit. Prandaj, është e vevojshme që, për të tejkaluar këtë situatë dhe për të mbështetur sipërmarrjet në këto kushte të vështira, krahas stimujve fiskalë që janë miratuar dhe do të miratohen në të ardhmen, të krijohen mundësi edhe për legalizimin e kapitaleve dhe pasurive, të cilat, për shkaqe të ndryshme nuk janë deklaruar apo ligjësuar. Një masë e tillë do të lehtësojë frymëmarrjen e ekonomisë dhe të sipërmarrjeve, duke shtuar burimet financiare legale për financimin e veprimtarive ekonomike dhe rritjen e konsumit.

Sqarojmë se ndërmarrja e një iniciative të tillë ka qenë kërkesë e hershme e sipërmarrjeve dhe e organizatave përfaqësuese të biznesit.

Me qëllim përmbushjen sa më të plotë të këtyre objektivave, amnistia është hartuar në mënyrë të tillë që nuk lejon ligjësimin e kapitaleve apo të financave të subjekteve kriminale, atyre të ekspozuar ndaj krimit dhe kriminalitetit apo subjekteve të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, kanë një ekspozim politik. Në dispozitat e këtij ligji janë përcaktuar qartësisht subjektet, subjektet përfituese si dhe subjektet që përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij ligji.

Projektligji ka përcaktuar rregullat dhe garancitë, veprimet e subjekteve që përfitojnë nga procesi i deklarimit vullnetar të pasurive si dhe kompetencat e organeve të administratës publike dhe organeve jopublike që marrin pjesë në këtë proces, si dhe veprimtaritë e lidhura me këtë proces.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është mbështetur në nenet 78, 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “ë”, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 parashikohet objekti i këtij projektligji, që përcakton rregullat, garancitë, veprimet e subjekteve, që përfitojnë nga procesi i deklarimit vullnetar të pasurive, si dhe kompetencat e organeve të administratës publike dhe organet jopublike që marrin pjesë në këtë proces, si dhe veprimtaritë e lidhura me këtë proces.

Në nenin 2 parashikohet qëllimi i projektligjit, që konsiston në garantimin e procedurave transparente për të mundësuar ligjësimin e pasurive të padeklaruara dhe/ose të paregjistruara, tërësisht apo pjesërisht, rivlerësimin e pasqyrave financiare si dhe mbledhjen e tatimeve përkatëse si dhe në parashikimin e mekanizmave nxitës për subjektet e këtij ligji, me qëllim sigurimin e tyre se nga procesi i ligjësimin të të ardhurave me të cilat janë krijuar pasuri, autoritetet publike do të aplikojnë një tatim favorizues të posaçëm me normë të veçantë, garantimin e ruajtjen së sekretit dhe të informacioneve që lidhen me këto pasuri, si dhe mosfillimin e procedurave administrative e të procedimeve penale ndaj këtyre subjekteve, nga ana e institucioneve përkatëse, në lidhje me këto pasuri.

Në nenin 3 jepen përkufizimet e të gjitha termave të përdorur në kuptim të këtij projektligji.

Në nenin 4 parashikohet raporti i dispozitave të këtij ligji me dispozitat e tjera ligjore, duke përcaktuar se dispozitat e legjislacionit në fushën tatimore, të cilat parashikojnë kompetencat e organeve të administratës publike përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të sektorit, duke përfshirë edhe përgjegjësinë për fillimin e procedurave administrative, gjatë kohës së zbatimit të këtij projektligji, aplikohen në përputhje me këtë projektligj. Dispozitat e këtij projektligji nuk zbatohen për pasuritë që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, dhe mbi pasuritë, objekt i zbatimit të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, miratuar me ligjin nr.18/2020.

Dispozitat e ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.90/2019, “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij projektligji.

Në nenin 5 parashikohen subjektet dhe subjektet që përfitojnë nga procesi i deklarimit të pasurive. Subjekte të këtij projektligji janë individët shtetas të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse janë rezidentë tatimorë ose jo në Republikën e Shqipërisë, personat fizikë dhe juridikë, tatimpagues rezidentë në Republikën e Shqipërisë, si dhe individët rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht shtetësisë së tyre. Subjekte përfituese të këtij projektligji janë subjektet e mësipërme, që kanë kryer procesin e deklarimit vullnetar dhe janë pajisur me vërtetimin e përfundimit të procesit të deklarimit të pasurive, sipas parashikimeve të këtij projektligji.

Në nenin 6 parashikohen subjektet e përjashtuara nga ky projektligj, duke përcaktuar se janë subjekte të përjashtuara nga zbatimi i këtij projektligji:

- Subjektet që kanë detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë, në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe personat në përbërje të gjendjes familjare të tyre, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, si më poshtë vijon:
 - a) Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat;
 - b) Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;
 - c) Zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, me përjashtim të organeve të vetëqeverisjes vendore;
 - ç) Prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve dhe kryetarët e bashkive;
 - d) Drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ të Shtetit;
 - dh) Prokurorët, gjyqtarët, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror dhe drejtuesit e zyrave përmbarimore, brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë;
 - e) Drejtuesit e institucioneve të pavarura publike dhe anëtarët e enteve rregullatore;
 - ë) Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Policisë së Shtetit, drejtorët e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtorët e drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorët e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit, drejtuesi dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të Byrosë

Kombëtare të Hetimit, nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe personeli administrativ i Prokurorisë së Posaçme;

- f) Drejtori i Përgjithshëm, zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive, në qendër dhe qarqe, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
 - g) Drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e të kompensimit të pronave, të privatizimit dhe të regjistrimit të pasurisë;
 - gj) Zyrtarët, që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta;
 - h) Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatori dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës të saj;
 - i) Drejtuesit e institucioneve publike në varësi të institucioneve qendrore në nivel qarku;
 - j) Administratorët e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe me më shumë se 50 punëtorë;
 - k) Anëtari i institucionit të rivlerësimit (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe komisionerët publikë), Sekretari i Përgjithshëm, këshilltarët ekonomikë dhe ligjorë, si dhe personat e lidhur me ta, sipas ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Subjektet, të cilat kanë qenë mbajtëse të detyrave apo të funksioneve sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, si dhe personat në përbërje të gjendjes familjare të tyre, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
 - Subjektet e ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.
 - Subjektet, sipas përcaktimit të nenit 16, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, miratuar me ligjin nr.18/2020.
 - Personat e shpallur dhe personat, për të cilët ka filluar procedura e shpalljes, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Në nenin 7 parashikohet Njësia Speciale për Mbikëqyrjen e Deklarimit Vullnetar të Pasurive (Njësia Speciale), në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të

Përgjithshëm të Tatimeve si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë Speciale në zbatim të këtij projektligji.

Konkretisht, përcaktohet se detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë Speciale janë kontrolli i zbatimit të dispozitave të këtij projektligji, krijimi i evidencave dhe i statistikave në lidhje me efektet e zbatimit të projektligjit, mbledhja e informacioneve, përditësimi dhe përpunimi i të dhënave, sigurimi i ruajtjes së fshehtësisë dhe i konfidencialitetit të informacionit në lidhje me të dhëna, si dhe kryerja e veprimeve administrative e procedurale, në zbatim të këtij projektligji. Në përmbushje të detyrave të veta për zbatimin e këtij projektligji, Njësia Speciale koordinon punën dhe bashkëpunon me bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera financiare në Republikën e Shqipërisë, autoritetet mbikëqyrëse të institucioneve financiare bankare, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, institucionet ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, Prokurorinë dhe Shërbimin Informativ të Shtetit, si dhe me institucione të tjera, veprimtaria e të cilave është e lidhur drejtpërdrejt me procesin e deklarimit të pasurive.

Në nenin 8 parashikohet procedura e deklarimit vullnetar të pasurive dhe e pasqyrave financiare. Subjektet e këtij projektligji mund të deklarojnë vullnetarisht pasuritë dhe elemente të pasqyrave financiare, pavarësisht nëse pasuritë, në tërësinë apo pjesë të tyre, janë të padeklaruara apo të paregjistruara në autoritetet kompetente, apo ndodhen ose jo në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 9 parashikon deklarimin vullnetar të shumave në të holla me anë të formularit të deklarimit vullnetar për depozitim të shumës në të holla në një numër llogarie bankare të hapur prej tyre për këtë qëllim.

Në nenin 10 parashikohet deklarimi vullnetar i pasurive të tjera të ndryshme nga shumat në të holla, të cilat deklarohen pranë Njesisë Speciale, nëpërmjet paraqitjes së formularit të deklarimit vullnetar.

Në nenin 11 përcaktohet deklarimi vullnetar i elementeve të veçanta të pasqyrave financiare. Subjektet e këtij projektligji mund të rideklarojnë elemente të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare të shoqërisë, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, me synimin për të siguruar një paraqitje reale, të vërtetë dhe e drejtë të çdo elementi të aktiveve dhe të detyrimeve të këtyre pasqyrave.

Në nenin 12 parashikohen vlerat e tatimit të posaçëm për kategoritë individ dhe tatimpagues. Po ashtu, vlerat e tatimit parashikohen në varësi të momentit të kryerjes së deklarimit dhe të pagesës, referuar kohës së hyrjes në fuqi të projektligjit.

Në nenin 13 parashikohet riatdhesimi i pasurive, përfshirë shumat në të holla, që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe mund të riatdhesohen me pagimin e tatimit të posaçëm, sipas parashikimit të nenit 12, të këtij projektligji.

Në nenin 14 përcaktohen rastet e ndërprerjes së procedurës së deklarimit vullnetar dhe efektet e saj. Procedura e deklarimit vullnetar konsiderohet e ndërprerë, me vetëdeklarim të subjektit, në çdo kohë, pas fillimit të procedurës së deklarimit vullnetar pa pasur nevojë që të shprehë shkaqet e ndërprerjes, me përfundimin e afatit të zbatimit të projektligjit dhe mosplotësimin e kushteve të parashikuara në pikën 1, të nenit 15, të këtij projektligji.

Në nenin 15 parashikohen kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që të quhet e përfunduar procedura e deklarimit vullnetar, si më poshtë vijon:

- Me vetëdeklarim të subjektit, në çdo kohë, pas fillimit të procedurës së deklarimit vullnetar, pa pasur nevojë që të shprehë shkaqet e ndërprerjes;
- Me vdekjen apo likuidimin e subjektit deklarues, sipas rastit;
- Me përfundimin e afatit të zbatimit të ligjit dhe mosplotësimin e kushteve të parashikuara në pikën 1, të nenit 15, të këtij ligji.

Në nenin 16 të projektligjit detajohen të gjitha efektet që sjell përfundimi i procedurës së deklarimit vullnetar për individët, personat fizikë dhe personat juridikë, subjekte përfituese, sipas parashikimeve të këtij projektligji.

Në nenin 17 parashikohet falja e gjobave/kamatëvonesave/penalitetëve për veprimet me pasuritë e deklaruara për të gjitha subjektet përfituese, sipas përcaktimeve të këtij projektligji. Parashikimet e neneve 16 dhe 17, të projektligjit nuk zbatohen ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 6, i tij. (subjektet e përjashtuara).

Në nenin 18 përcaktohen kushtet për dhënien e amnistisë nga ndjekja penale për subjektet përfituese, ndaj të cilave është lëshuar vërtetimi përkatës i përfundimit të procesit të deklarimit vullnetar. Konkretisht, dispozita parashikon subjektet përfituese, ndaj të cilave është lëshuar vërtetimi përkatës i përfundimit të procesit të deklarimit vullnetar, që përjashtohen nga ndjekja penale për veprat penale që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me krijimin dhe disponimin e pasurisë së deklaruar, sipas kushteve të përcaktuara në këtë projektligj, të kryera deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij projektligji. Nuk përfitojnë nga parashikimi i mësipërm, subjektet e parashikuara në nenin 6, të këtij projektligji.

Në nenin 19 parashikohet koha e zbatimit të këtij projektligji. Ky projektligj zbatohet për një afat deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj nga fillimi i efekteve të zbatimit të tij, për subjektet deklaruese. Për organet e administratës publike të përfshira në procesin e deklarimit vullnetar të pasurive, ky afat shtrihet deri në përfundimin e shqyrtimit të deklarimeve të kryera brenda afatit të mësipërm, sipas përcaktimeve të këtij projektligji.

Ky parashikim është vendosur me qëllim që t'i lihet kohë organeve të administratës që të shqyrtojnë brenda afatit 20-ditor, të parashikuar në ligj, aplikimet që eventualisht mund të kryhen në ditët e fundit të zbatimit të këtij projektligji nga subjektet deklaruese dhe shmangien e keqinterpretimeve të mundshme sa i takon mundësisë që i jepet subjekteve përkatëse deklaruese për përfundimin e procesit të deklarimit vullnetar.

Në nenin 20 parashikohet nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore nga ministri përgjegjës për financat, në zbatim të këtij projektligji.

Në nenin 21 parashikohet hyrja në fuqi, përkatësisht, 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe efektet e zbatimit fillojnë 30 ditë nga hyrja në fuqi e tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe të gjitha institucionet dhe organet e përmendura në projektligj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga grupi ndërinstitucional i punës, i ngritur me urdhrin nr.80/2020, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit “Për amnistinë fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklarim vullnetar të pasurive””, me përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Projektligji i është dërguar për mendim dhe institucioneve si Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Struktura e

Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk parashikon efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE